

SHKOLLIMI I DETYRUESHËM

Ka tri cikle shkollore (tri etapa):

- **Cikli 1** : Nga viti i 1^{te} deri në vitin e 4^{te} (nxënësit nga 4 deri në 8 vjeç)
- **Cikli 2** : Nga viti i 5^{te} deri në vitin e 8^{te} (nxënësit nga 8 deri në 12 vjeç)
- **Cikli 3** : Nga viti i 9^{te} deri në vitin e 11^{te} (nxënësit nga 12 deri në 15 vjeç)



KONTEKSTI ROMAND

Konventa shkollore romande përcakton bashkëpunimin midis kantoneve pikërisht për Planin romand të studimeve si dhe për librat dhe broshurat (mjetet mësimore)

>>> Më shumë informacione në sitin: www.ciip.ch

KONTEKSTI KOMBËTAR DHE NDËRKANTONAL

Zvicra ka miratuar **Marrëveshjen ndërkantonale për harmonizimin e shkollimit të detyrueshëm** (marrëveshja HarmoS) që përcakton pikërisht kohëzgjatjen e shkollës së detyrueshme (11 vjet) dhe moshën e fillimit të shkollimit 4 vjeç.

>>> Më shumë informacione në sitin: www.cdip.ch



PERSPEKTIVAT

Libra dhe broshura romande përdoren në lidhje me Planin romand të studimeve.

>>> Planifikimi i mjeteve mësimore romande gjendet në sitin www.ciip.ch

PLATFORMA E PLANIT ROMAND TË STUDIMEVE

Planin romand i studimeve mund të gjendet në linjë. Në sit, mund të keni qasje edhe në dokumentet e secilit kanton.



>>> Gjejeni të plotë PER-in në sitin www.per-mer.ch

 Office de l'école obligatoire et du conseil
Chemin des Lovières 13
2720 Tramelan
T +41 31 636 16 60
www.bkd.be.ch/fr/start.html

 Service de l'enseignement obligatoire de langue française
Rue de l'Hôpital 1
1700 Fribourg
T +41 26 305 12 27
www.fr.ch/dfac/senof

 Direction générale de l'enseignement obligatoire
Chemin de l'Echo 5A
1213 Onex
T +41 22 327 04 00
www.ge.ch/organisation/direction-generale-enseignement-obligatoire

 Service de l'enseignement
Route de Moutier 16
2800 Delémont
T +41 32 420 54 10
www.jura.ch/sen

 Service de l'enseignement obligatoire
Rue de l'Ecluse 67
2002 Neuchâtel
T +41 32 889 69 20
www.ne.ch/autorites/DFDS/SEEO/Pages/accueil.aspx

 Service de l'enseignement
Place de la Planta 1
1950 Sion
T +41 27 606 42 00
www.vs.ch/web/def

 Direction générale de l'enseignement obligatoire et de la pédagogie spécialisée
Rue de la Barre 8
1014 Lausanne
T +41 21 316 32 32
www.vd.ch/def/dgeo

ciip:

Faubourg de l'Hôpital 68
Case postale 556
CH-2002 Neuchâtel

T +41 32 889 69 72
ciip@ne.ch
www.ciip.ch

Conférence intercantonale
instruction publique et culture
Suisse romande et Tessin



Version simplifiée

Plani romand i studimeve (PER) Dokument informues për prindërit

Në Zvicrën romande, nxënësit/et ndjekin të tërë e të tëra, Planin romand të studimeve (PER).

Të dashur Prindër,

Plani romand i studimeve mundëson harmonizimin në kantonet romande Ai është bërë pas një konsultimi të madh dhe një pajtimi të gjerë.

Ai është referenca qendrore dhe e përbashkët e asaj që duhet të dinë nxënësit e Zvicrës romande. Ai ka të bëjë me të gjitha vitet e shkollës nga klasa e 1^{re} fillore deri në vitin e 11^{të}. Çdo vit, mësuesi mund të plotësojë kursin e tij me dokumente të reja

Ky dokument paraqet në mënyrë globale parimin e PER-it.

Broshura e plotë gjendet në sitin www.per-mer.ch.

Ju mund të kërkon versionet e përkthyer në shërbimin e arsimit të kantonit tuaj.

<https://portail.ciip.ch/per/pages/informations-parents/>



Konferenca latine e arsimit të detyrueshëm, qershor 2024



NJË VULLNET POLITIK

Të gjitha kantonet romande kanë një vizion të njëjtë për shkollën dhe formimin e nxënësve.

Ky vullnet politik dëshiron t'u japë të gjithë fëmijëve njohuri dhe aftësi me qëllim që ata të zhvillohen sa më mirë.

« Shkolla publike merr përsipër misionin për arsimimin dhe kalimin e kulturës pranë të gjithë nxënësve. Ajo siguron ndërtimin e njohurive dhe përvetësimin e aftësive që i mundësojnë secilit e secilës zhvillimin e potencialeve të veta në mënyrë optimale. »

QËLLIMET DHE OBJEKTIVAT

Kultura, vlerat dhe dijet thelbësore transmetohen në shkollë.

>>> Për më shumë informacione: www.per-mer.ch



Një projekt global formimi

Plani romand i studimeve (PER) paraqet gjithçka që duhet të mësojë e të dijë një nxënës gjatë shkollimit të detyrueshëm.

PLANI ROMAND I STUDIMEVE ËSHTË ORGANIZUAR NË TRI PJESË:

FUSHAT LËNDORE

AFTËSITË
TRANVERSALE

FORMIMI I
PËRGJITHSHËM

Gjatë tërë viteve të shkollës së detyrueshme.

Fushat lëndore

Fushat lëndore rigrupojnë shumë lëndë shkollore që kanë lidhje midis tyre, për shembull frëngjishtja, gjermanishtja dhe anglishtja janë në Fushën e Gjuhëve.



GJUHËT

Nxënësi mëson të komunikojë, të flasë e të shkruajë më mirë, në frëngjisht, por edhe në gjermanisht e anglisht.

MATEMATIKA DHE SSHKENCAT E NATYRËS

Nxënësi mëson bazat e matematikës e të shkencave. Ai zhvillon gjithashtu frymën shkencore për zgjidhjen e problemeve dhe situatave konkrete.

SHKENCAT NJERËZORE DHE SHOQËRORE

Nxënësi mëson si të njohë historinë, gjeografinë, si dhe se çfarë është qytetaria. Këto njohuri i mundësojnë atij njohjen më të mirë të shoqërisë së sotme.

ARTET


Nxënësi kryen veprimtari kulturore e artistike si vizatimi, muzika ...

TRUPI DHE LEVIZJA

Nxënësi kryen veprimtari sportive dhe mëson gjithashtu si të ketë një ushqyerje të mirë.

EDUKIMI NUMERIK

Nxënësi mëson si të njohë më mirë mjetet numerike (ordinator, telefon ...) me anën e teknikës, por edhe duke menduar për përdorimin e tyre.



Formimi i përgjithshëm

Formimi i përgjithshëm rigrupon atë që shkolla duhet t'i mësojë secilit nxënës.

Nuk bëhet fjalë për kurse në veçanti. Por në tërësinë e kurseve, shkolla kujdeset për shëndetin, mirëqenien, jetën e përbashkët dhe demokracinë. Shkolla e shoqëron nxënësin në zgjedhjet dhe projektet e tij vetjake.

Aftësitë transversale

Aftësitë transversale rigrupojnë gjithçka që është e domosdoshme për suksesin shkollor të nxënësve.

Këto aftësi transversale përftohen gjatë tërë shkollimit në secilin kurs.

Bëhet fjalë pikërisht për:

- > bashkëpunimin midis nxënësve
 - > komunikimin
 - > strategjitë për të mësuar më mirë
 - > mendimin krijues, si të gjendet diçka e re përballë një problemi
 - > Të vepruarit e menduar, si të mendohet përballë një problemi
- Këto aftësi janë shumë të rëndësishme kur dilet nga shkolla në botën profesionale.

